

VENDIM
Nr. 33, datë 13.5.2014

**MBI KËRKESËN E NJËRIT PREJ AKSIONARËVE TË SHOQËRISË “PROJEKSION ENERGJI” SHA
PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONARËVE TË ERE-S NR. 26, DATË
21.3.2014 “MBI KËRKESËN E NJË PREJ AKSIONARËVE TË SHOQËRISË “PROJEKSION
ENERGJI” SHA PËR HEQJEN E LICENCËS DHE ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES MIDIS
PALËVE”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 1 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, pasi u njoh me relacionin e për gatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e aksionarit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. z. Sokol Riska, për rishikimin e vendimit nr. 26, datë 21.3.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së aksionarit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., z. Sokol Riska, si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në ndryshimin e vendimit nr. 26, datë 21.3.2014.
2. Lënien në fuqi të vendimit Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 26, datë 21.3.2014, “Mbi kërkesën e një prej aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. për heqjen e licencës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve”.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti